



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin “Albafilm” SH.A

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
AUDITIM FINANCIAR

Tiranë, shkurt 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-9
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-5
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-8
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-9
II.	HYRJA	9-13
1	Objektivat \ dhe qëllimi	9
2	Identifikimi i çështjes	10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
5	Kriteret e vlerësimit	11
6	Standardet e auditimit	11-12
7	Metodat e auditimit	12
8	Dokumentimi i auditimit	13
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13
2.1	Auditim mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.	13-21
2.2	Auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.	21-28
2.3	Auditim mbi evidencën kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij nga organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.	28-41
IV	REKOMANDIME	41-45

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Albafilm sh.a. është një shoqëri aksionare me pronësi shtetërore në Shqipëri, e cila vepron në fushën e kinematografisë dhe trashëgimisë filmike kombëtare. Institucioni ka si mision kryesor administrimin, ruajtjen, restaurimin dhe promovimin e fondit filmik shqiptar, duke përfshirë filma artistikë, dokumentarë dhe kronika historike.

Albafilm sh.a. luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore audiovizive të vendit, si dhe në vënien e saj në dispozicion të publikut, studiuesve dhe institucioneve kulturore. Përmes aktiviteteve të tij, institucioni kontribuon në edukimin kulturor, në ruajtjen e kujtesës historike dhe në promovimin e kinemasë shqiptare brenda dhe jashtë vendit.

Në bashkëpunim me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, Albafilm sh.a. mbështet gjithashtu projekte restaurimi, digjitalizimi dhe shpërndarjeje të materialeve filmike me vlerë historike dhe artistike.

Albafilm Sh.a nuk është financuar vetëm nga buxheti i shtetit si një institucion publik, por operon si shoqëri aksionare me kapital publik. Kjo do të thotë që financimi i saj mund të jetë një kombinim i:

- Shtetit/kapitalit shtetëror (kapitali fillestar dhe potencialisht subvencione nga Ministria e Kulturës).
- Të ardhurave të veta (nga qiratë e objekteve, shërbimet, rentë, bileta apo fitime nga aktivitetet e saj).
- Projekte dhe bashkëfinancimeve të mundshme nga donatorë ose programe ndërkombëtare.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i shoqërisë Albafilm sh.a. është një proces shumë i rëndësishëm për funksionimin e saj dhe për garantimin e menaxhimit të drejtë të pasurisë dhe fondeve publike.

- Siguron transparencë dhe llogaridhënie.

Auditimi synon të verifikojë se si janë përdorur fondet dhe asetet e shoqërisë, veçanërisht kur bëhet fjalë për fonde publike ose pasuri me vlerë historike dhe kulturore. Ky proces ndihmon në evidentimin e menaxhimit joefikas ose parregullsisive financiare dhe administrative.

- Parandalon dhe zbulon abuzimet dhe shkeljet.

- Dhënien e objekteve me qira pa respektuar procedurat ligjore.
- Mungesë inventarizimi të pasurive, përfshirë materiale filmike me vlerë historike.
- Marrje në punë të punonjësve pa miratimin e strukturave të duhura, duke rritur shpenzimet e shoqërisë pa justifikim.

- Mbron interesin publik dhe pasurinë kombëtare

Albafilm Sh.a menaxhon fonde dhe pasuri që kanë vlerë jo vetëm financiare, por edhe kulturore (arkivi filmik, objekte historike të kinostudios). Auditimi ndihmon që këto resurset të ruhen dhe përdoren në përputhje me ligjet dhe misionin e institucionit.

-Përmirëson menaxhimin financiar dhe efektivitetin.

-Rrit besimin e publikut dhe të financuesve.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësim me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Albafilm Sh.a. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.
- Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.
- Mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku.

Vlerësimi i riskut të kontrollit;

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2024 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 510 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 51 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli); Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 9 gjetje dhe ka dhënë 9 rekomandime, nga ku masa organizative me 6 gjetje dhe 6 rekomandime dhe 3 gjetje-rekomandim si efekt negativ në administrimin e fondeve publike.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- Strukturat drejtuese të “Albafilm” SHA, nuk kanë argumentuar ndryshimet e konsiderueshme të programit ekonomik si në shtesa edhe në pakësime për vitin 2023, e shfaqur në rritjen e fondit të pagave, rritjen e numrit të punonjësve, uljen e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve. Rezultati i aktivitetit të shoqërisë është planifikuar me humbje, pasi të ardhurat janë planifikuar më të ulta se shpenzimet.
- Relacionet për miratimin e programeve ekonomike të shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës, janë dërguar jashtë afatit, të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kreu III, pika 2, si dhe shkresat e dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
- Strukturat drejtuese, për zhvillimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, nuk kanë planifikuar investime për vitet 2023, 2024 dhe 2025.
- Peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve të shoqërisë 65-71%, për vitet 2023 - 2025, e zënë

shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve.

- Të ardhurat e shoqërisë në vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me vitin 2023 kanë ardhur në ulje, si pasojë e uljes së numrit të subjekteve që kanë ushtruar aktivitet nëpërmjet marrjes me qira të ambienteve në pronësi të “Albafilm” SHA.

- Shpenzimet në total janë planifikuar në rënie, ndërsa ato operative dhe pesha që zënë në totalin e shpenzimeve në vitin 2025, paraqiten me rritje krahasuar me vitet 2023 dhe 2024.

Shpenzimet operative për 9-mujorin e vitit 2025 janë realizuar në masën 126 % me një tejkalim + 26%, i cili do të thellohet me mbylljen e vitit 2025. Tejkalimi i shpenzimeve operative paraqitet në zërat “Shërbime”, “Tatim taksa”, “Pagesa e detyrimeve ndaj Ministrisë” dhe “Shpenzime gjyqësore”.

- Shoqëria ka dështuar në përmbushjen e misionit për të cilën është krijuar, ku si objekt veprimtarie janë 15 objektiva si: servisi i filmit artistik, ofrimi i shërbimeve në fushën e artit, realizimi i investimeve për prodhimin, përpunimin, shpërndarjen e produkteve artistike, veprimtari në fushën e marketingut, festivale, kinematografi etj. Është devijuar aktiviteti drejt një shoqërie që realizon të ardhura vetëm nga qiratë për objektet të cilat i ka në pronësi, por që i kanë kaluar në përdorim operatorëve ekonomikë bazuar në marrëveshjet e qirasë me Ministrinë e Ekonomisë. Objektet e dhëna me qira nga viti në vit janë reduktuar, pasi një pjesë e tyre janë privatizuar dhe shoqëria nuk përfiton të ardhura. Të ardhurat vjetore të shoqërisë nuk mjaftojnë as për shpenzime minimale si shpenzimet operative etj.

- Nga auditimi i ditarit të arkës u konstatua se për vitin 2024 nuk janë firmosur nga administratori 6 mandat pagesa. Për vitin 2025 u konstatua që të gjitha mandat pagesat nuk ishin të firmosura nga nëpunësi autorizues. Furnizimi me dokumente të përdorura për arkëtime dhe pagesa (mandat arkëtime dhe mandat pagesa), është kryer nga persona të rastësishëm shitës dhe jo nga shtypshkronja e letrave me vlerë. Mandat arkëtimet e përdorura nuk kanë numër serie të para shtypur. Përdorimi i këtyre dokumenteve që nuk përmbushin standardet ligjore për përdorim në sektorin publik ka risk të lartë që ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së auditimit.

- Nga verifikimi i regjistrimeve kontabël rezultuan mangësi në analizimin analitik dhe dokumentimin e disa llogarive kontabël, konkretisht në llogaritë “Klientë mbi një vit”, “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm” dhe “Të ardhura të shtyra”.

Llogaria “Klientë mbi një vit”, e kontabilizuar në vlerën 7,746,811 lekë, nuk është e analizuar në mënyrë analitike sipas klientëve dhe afateve përkatëse. Gjithashtu, llogaria 46 “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm” është kontabilizuar në vlerën 26,554,935 lekë, ndërkohë që analiza analitike e disponueshme përbëhet nga 12 debitorë me vlerë 7,616,429 lekë, ndërsa për diferencën prej 18,938,506 lekë nuk është paraqitur dokumentacion justifikues dhe analizë përkatëse. Po ashtu, llogaria “Të ardhura të shtyra”, e kontabilizuar në vlerën 27,025,055 lekë, nuk është e analizuar në mënyrë analitike.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 334,411,619 lekë në fund të vitit 2023 dhe e njëjta vlerë është pasqyruar edhe në fund të vitit 2024, pa ndryshime gjatë vitit ushtrimor.

Kjo llogari është kontabilizuar si një aktiv i vetëm, me një sipërfaqe totale prej 15,487 m², pa u ndarë analitikisht sipas pasurive përkatëse dhe dokumentacionit ligjor që vërteton të drejtat e pronësisë. Aktivitet duhet të kontabilizohen në këtë llogari sipas dokumentit ligjor.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare shoqëria “Albafilm” SHA nuk ka zbatuar një politikë për zhvlerësimin e inventarit gjatë periudhës 2023-2024. Si pasojë, nuk është e mundur të vlerësohet ndikimi i ndonjë korigjimi të mundshëm në pasqyrat financiare për këto vite, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë dhe besueshmërinë e vlerës së inventarit të raportuar.

- Nga auditimi u konstatua se, shoqëria “Albafilm” SHA ka disa çështje gjyqësore në proces me punonjës të larguar dhe palë të tjera të treta. Shoqëria nuk ka përlogaritur provizionet për humbje të mundshme nga këto çështje gjyqësore e cila është në kundërshtim me *SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”*, paragraph 24-25, SNK 37, “Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit për provizionet, detyrimet dhe aktet e kushtëzuara.

- Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua në vitin 2023 janë paguar gjoba për pagesë me vonesë dhe kamatëvonesa për pagesat e tatim fitimit të vitit 2019 dhe vitit 2020 në vlerën 570,569 lekë, e cila konsiderohet efekt negativ financiar i cili sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomikitet.

Mos analizimi i arsyeve të pagesave me vonese të tatimit mbi fitimin dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave me vonesë dhe në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative për shoqërinë.

- Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua në muajin shtator 2025 janë paguar gjoba për pagese të vonuar për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Tiranë në vlerën 142,681 lekë, e cila konsiderohet efekt negativ financiar duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomikitet. Mos analizimi i arsyeve të pagesave për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Tiranë dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave me vonese e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative për shoqërinë.

- Nga auditimi i pagesave të kryera në R. Bank u konstatua se në muajin shkurt 2025 janë paguar 2,274,257 lekë për vendime gjyqësore për largimet nga puna nga të cilat 2,073,135 lekë shpenzime gjyqësore, 99,975 lekë tarifa gjyqësore dhe tarifa përmbartimore 100,397 lekë.

Kjo shumë e paguar konsiderohet efekt negativ financiar, duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomikitet. Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave të vendimeve gjyqësore në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhetin e shoqërisë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Administratori i shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin në analizë situatën ekonomike-financiare në të cilën ndodhet shoqëria “Albafilm”, të hartojnë programe ekonomike për zhvillimin dhe rritjen e aktivitetit, të parashikojnë plan për investime sipas prioriteteve të zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë, referuar kapaciteteve dhe nevojave reale të tyre me qëllim arritjen e objektivave, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës ekonomike.

- Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa që veprimet e kryera për arkëtimet dhe pagesat që kryhen nëpërmjet arkës të përdoret dokumentacion me numër serie të para shtypur si dhe të nënshkruhen konform legjislacionit në fuqi.

- Drejtoria e Financës të marrë masa për kryerjen e analizimit analitik të plotë dhe sigurimin e dokumentacionit justifikues për llogaritë “Klientë mbi një vit”, “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm” dhe “Të ardhura të shtyra”.

-Drejtoria e Financës të marrë masa për ndarjen dhe kontabilizimin analitik të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” sipas çdo pasurie individuale dhe dokumentit ligjor përkatës.

-Drejtoria e Financës duhet të përllongarisë dhe regjistrojë provigjionet për humbjet e mundshme nga çështjet gjyqësore për të siguruar që pasqyrat financiare të pasqyrojnë saktë detyrimet e mundshme.

- Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive administrative për personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të shoqërisë në vlerën 570,569 lekë, gjoba dhe kamatëvonesa për pagesat me vonese të tatimit mbi fitimin e vitit 2019 dhe vitit 2020.

- Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive administrative për personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të shoqërisë në vlerën 142,681 lekë, gjoba dhe kamatëvonesa për pagesat me vonesë për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Tiranë

- Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të shoqërisë në vlerën 2,274,257 lekë, shpenzime gjyqësore dhe përmbarrimore mbi pagesën e kryer për vendimet gjyqësore për gjyqe fituesin .

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2024:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë Albafilm Sh.a për vitin ushtrimor 01.01.2024-31.12.2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar me theksim çështje¹:

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë Albafilm Sh.a më 31 dhjetor 2024, referuar ligjit nr.25/2018 “ *Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare* ”.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (SNA-700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të

¹ Një opinion me “*Theksim Çështjeje*”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 431 mijë leke.

Theksimi i çështjes:

- Llogaria “*Klientë mbi një vit*”, e kontabilizuar në vlerën 7,746,811 lekë, nuk është e analizuar në mënyrë analitike sipas klientëve dhe afateve përkatëse.

- Llogaria “*Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm*” është kontabilizuar në vlerën 26,554,935 lekë, ndërkohë që analiza analitike e disponueshme përbëhet nga 12 debitorë me vlerë 7,616,429 lekë, ndërsa për diferencën prej 18,938,506 lekë nuk është paraqitur dokumentacion justifikues dhe analizë përkatëse.

- Llogaria “*Të ardhura të shtyra*”, e kontabilizuar në vlerën 27,025,055 lekë, nuk është e analizuar në mënyrë analitike.

- Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” llogari është kontabilizuar si një aktiv i vetëm, me një sipërfaqe totale prej 15,487 m², pa u ndarë analitikisht sipas pasurive përkatëse dhe dokumentacionit ligjor që vërteton të drejtat e pronësisë.

-Llogaritë e klasës 3 të “*Inventarët*” për periudhën 2024 nuk i janë nënshtruar testit të zhvlerësimit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 1048/1, datë 05.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 04.11.2025 deri në datë 24.12.2025, në subjektin Albafilm Sh.a për periudhën 01.01.2023 - 30.09.2025 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K. H, Përgjegjës grupi
2. M. B, audituese
3. L. Gj, auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023-2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të shoqërisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Projekt Raporti i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së shoqërisë Albafilm.

2. Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI

13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të shoqërisë Albafilm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Administratori i Shoqërisë, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori është përgjegjës për vendosjen, përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të shoqërisë, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë Albafilm Sh.a dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Shoqërisë Albafilm Sh.a është zhvilluar në përputhje me kriteret e

paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 4, datë 26.01.2024 “*Për miratimin e manualit të MFK*”;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; ; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”.

6. Standardet e auditimit.

ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve,

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

▪ *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 3 akt-konstatime. Pas hartimit të projekt-raportit dhe dërgimit në subjekt, sipas përcaktimeve ligjore, nuk janë paraqitur observacione nga subjekti Shoqëria Albafilm Sh.a.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Albafilm është një shoqëri publike shqiptare, e themeluar në vitin 2007, që ka për objekt kryesor veprimtarinë kulturore dhe kinematografike – prodhimin, promovimin dhe menaxhimin e filmave dhe aktiviteteve artistike – dhe funksionon nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit në përputhje me legjislacionin shqiptar për shoqëritë aksionare.

Auditimi i Shoqërisë Albafilm ka rëndësi të veçantë për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), sepse lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e filmit shqiptar e cila ka interes publik të lartë.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Auditim mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.

Në lidhje me procedurat e ndjekura për hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik për periudhën e auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Statuti dhe Rregullorja e brendshme e shoqërisë.
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e “Albafilm” SHA.
- Zbatimi i kriterëve në programim.
- Programet e miratuara dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
- Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, konstatohet se:

➤ Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i programit ekonomik.

Për periudhën objekt auditimi (2023-9-mujori 2025), strukturat drejtuese të “Albafilm” SHA, për realizimin e objektivave referuar detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Vendimi nr.711, datë 09.09.2020 “Për transferimin e pronësisë 100% të aksioneve të shoqërisë “Albafilm” SHA, Tiranë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Ministria e Kulturës”, Udhëzimi i MFE nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Administratori i shoqërisë ka

nxjerrë urdhrat përkatës me objekt *“Për përgatitjen e projekt programit ekonomik”*.

Për ushtrimin e aktivitetit janë hartuar dhe miratuar programet ekonomike dhe financiare të zhvillimit për vitet 2023, 2024 dhe 2025. Në lidhje me hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik për periudhën objekt auditimi, janë paraqitur treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara, gjithashtu është bërë edhe krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara me planin.

Për vitin 2023, procesi për përgatitjen e projektit të programit ekonomik për vitin 2023 ka filluar me kërkesën për miratim dhe relacionin shpjegues për miratimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albafilm” SHA, paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr. 309, datë 21.12.2022. Në këtë proces nuk është nxjerrë urdhër nga Administratori për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e programit ekonomik.

Programi Ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 22.12.2022, është dërguar në Ministri për informacion me shkresën nr.7176 prot, datë 23.12.2022 dhe është miratuar me vendimin e nr.35, datë 20.01.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Strukturat drejtuese kanë kërkuar ndryshime në programin ekonomik të cilat janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, si më poshtë:

-Me vendimin nr.7, datë 14.07.2023, "Mbi miratimin e ndryshimit të programit ekonomik 2023, miratimin e kryerjes së shpenzimit dhe përdorimit e r rezervave të akumuluar të shoqërisë", është miratuar kryerja e shpenzimit të ekspertizës dhe shërbimeve ligjore në fushën e kinematografisë me mjete elektronike, në vlerën 5,500,000 lekë.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës është miratuar me vendimin nr.488, datë 04.08.2023, të Asamblesë së Përgjithshme.

Për vitin 2024, procesi për përgatitjen e projektit të programit ekonomik për vitin 2024 ka filluar me urdhrin e titullarit nr.74, datë 31.10.2023, kërkesa për miratim dhe relacioni shpjegues për miratimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albafilm” SHA është paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr. 224, datë 22.12.2023.

Programi Ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 05.01.2024, është dërguar në Ministri për informacion me shkresën nr. 1/1 prot, datë 08.01.2024 dhe është miratuar me vendimin e nr.131/1, datë 11.01.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Për vitin 2025, procesi për përgatitjen e projektit të programit ekonomik për vitin 2025 ka filluar me kërkesën për miratim dhe relacionin shpjegues për miratimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albafilm” SHA, paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr. 156, datë 30.12.2024. Në këtë proces nuk është nxjerrë urdhër nga Administratori për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e programit ekonomik.

Programi Ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 07.01.2025, është dërguar në Ministri për informacion me shkresën nr. 1/1 prot, datë 08.01.2025 dhe është miratuar me shkresën nr. 266/2, datë 27.01.2025 të Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

-Në urdhrat e titullarit nuk është përcaktuar grupi i punës për hartimin e programeve ekonomike të zhvillimit të shoqërisë, sipas Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” Kreu I, pika 4.

-Relacionet për miratimin e programeve ekonomike të shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës, janë dërguar përkatësisht me shkresat nr. 309, datë 21.12.2022, nr.224, datë 22.12.2023 dhe nr.156,

datë 30.12.2024, jashtë afatit (brenda datës 1 Dhjetor të çdo viti), të përcaktuar në udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” Kreu III, pika 2, dhe shkresat e dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

➤ Në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe urdhrin e MFE nr.125, datë 08.04.2019 “Për raportimin në Këshilla Mbikëqyrës” paraqitja në Ministri dhe Këshillin Mbikëqyrës, e raporteve 3- mujore dhe vjetore të veprimtarisë së shoqërisë është kryer si më poshtë:

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 3-mujorit I, të **vitit 2023**, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 16/1, prot. datë 25.04.2023.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 6-mujorit, të vitit 2023, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 153, prot. datë 11.07. 2023.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 9-mujorit, të vitit 2023, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 153/1, prot. datë 09.10. 2023.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të vitit 2023, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 17, prot. datë 23.01.2024

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 3-mujorit I, të **vitit 2024**, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 64, prot. datë 17.04.2024.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 6-mujorit, të vitit 2024, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 64/1, prot. datë 12.07.2024.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 9- mujorit të vitit 2024 është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 130, prot. datë 17.10.2024, ndërsa relacioni vjetor nuk është dërguar.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 3-mujorit I, të **vitit 2025**, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 45, prot. datë 18.04.2024.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik - financiar të 6-mujorit, të vitit 2025, është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 45/1, prot. datë 08.07.2025.

-Relacioni për realizimin e treguesve ekonomik financiar të 9- mujorit të vitit 2025 është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Turizmit Kulturës dhe Sportit, me shkresën nr. 45/2, prot. datë 17.10.2025.

-Nuk është dërguar relacioni vjetor i vitit 2024 sipas urdhrin të MFE nr.125, datë 08.04.2019 “Për raportimin në Këshilla Mbikëqyrës”.

Tabela nr. 1: Buxheti i miratuar për vitet 2023, 2024 dhe 2025, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2023			Viti 2024			9-mujor 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
I	Të Ardhura	19,686	23,055	117	23,055	22,674	98.3	22,925	16,970	74
II	Shpenzime	32,007	25,501	80	22,921	22,667	99	17,865	16,749	94
III	Investime	-			-			-		

Burimi i të dhënave: Albafilm

Për vitin 2023, diferenca midis shpenzimeve dhe të ardhurave të planifikuara është +12,321 mijë lekë, ndërsa fakti +2,446 mijë lekë, veprime që tregojnë se shoqëria ka tejkaluar shpenzimet krahasuar si me planin ashtu edhe me faktin e të ardhurave.

Për vitin 2024 dhe 9-mujorin e 2025, nuk rezultojnë diferenca në tejkallim të shpenzimeve në total, krahasuar me të ardhurat.

Ndryshimet krahasuar me planin fillestar për vitin 2023, të ardhurat janë ulur në vlerën 6,280 mijë lekë, shpenzimet janë rritur në vlerën 6,055 mijë lekë dhe fondi pagave është rritur në vlerën 115 mijë lekë, ndikuar nga rritja e pa argumentuar e numrit të punonjësve nga 9 në 13 punonjës.

Tabela nr. 2: Ndryshimet krahasuar me planin fillestar 2023.

000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan	Plani ndryshuar
1	Të ardhura gjithsej	25,966	(- 6,280) 19,686
2	Shpenzime gjithsej	25,952	(+ 6,055) 32,007
3	Fitimi bruto	13	(12,320)
4	Fitimi/Humbje neto	11	(12,320)
5	Fondi pagave	16,913	(+ 115) 17,028

Burimi i të dhënave: Albafilm

Konstatohet se strukturat drejtuese të “Albafilm” SHA, për zhvillimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, nuk kanë planifikuar investime për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

- **Të ardhurat e “Albafilm”SHA,** realizohen nga 4 burime:
- kontratat e qirasë për ambiente mbi 200 m² (nënshkruar nga ME)
 - kontratat e qirasë për ambiente nën 200 m² (nënshkruar nga shoqëria)
 - të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e materialeve të rekuizitës
 - interesat bankare.

Tabela nr. 3: Në mënyrë të detajuar programimi dhe realizimi i të ardhurave paraqitet në tabelën si më poshtë:

Në 000/lekë

Vitet	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025 realizimi 9- mujor		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Të Ardhurat	19,686	23,055	117	23,055	22,539	98	22,925	16,970	74
Kontrata > 200m ²	20,362	20,362	100	20,362	20,232	99	20,362	15,272	75
Kontrata < 200 m ²	2,197	1,879	107	1,742	1,669	96	1,742	1,380	79
Qira nga rekuizita	150	64	43	90	-	-	40	2.2	5.5
Interesat bankare	756	750	99	756	638	84	750	316	42

Burimi i të dhënave: Albafilm

Të ardhurat për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 19,686 mijë lekë, realizuar në vlerën 23,055 mijë lekë, ose në masën 117 % në krahasim me planifikimin vjetor.

Shoqëria realizon të ardhura kryesisht nga dhënia me qira e objekteve, të cilat janë edhe burimi

kryesor i të ardhurave. Për vitin 2023 shoqëria ka parashikuar të ardhurat nga 4 subjekte me të cilat ka kontrata me afat 20 vjeçar të cilat janë nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë dhe 9 subjekte me të cilat ka kontrata qiraje me afat 1 vjeçar të nënshkruara çdo vit nga institucioni. Gjithashtu, shoqëria përfiton të ardhura nga interesat bankare të depozitës që ajo ka në bankën “C.” dhe dhënia me qira e rekuizitës.

Tabela nr. 4: Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2023 si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nipti	Detyrimi mujor	Të ardhurat vjetore
-	Kontrata mbi 200m²			
1	N. AH	K92	111,740	1,340,880
2	AA	K52	699,180	8,390,160
3	Me	K51	241,000	2,892,000
4	S. ShPK	K12	644,940	7,739,280
-	Kontrata nën 200 m²			
5	B. ShPK	J72	24,200	290,400
6	R.E	L22	24,200	290,400
7	A.S	L91	24,200	290,400
8	E.S	M3	24,200	193,600
9	S.S	M1	24,200	290,400
10	TV K	J71	16,500	115,500
11	H.Gj	L52	24,200	290,400
12	N.Gj	L62	24,200	96,800
13	L.D	L62	21,400	21,400
14	Qira rekuizite		-	64,000
15	Interesat bankare		-	750,000
	Shuma			23,055,620

Burimi i të dhënave: Albafilm

Të ardhurat për vitin 2024, janë parashikuar në vlerën 23,055 mijë lekë, janë realizuar në vlerën 22,674 mijë lekë, ose në masën 98% në krahasim me planifikimin vjetor. Shoqëria realizon të ardhura kryesisht nga dhënia me qira e objekteve, të cilat janë edhe burimi kryesor i të ardhurave. Për vitin 2023 shoqëria ka parashikuar të ardhurat nga 4 subjekte me të cilat ka kontrata me afat 20 vjeçar të cilat janë nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë dhe 6 subjekte me të cilat ka kontrata qiraje me afat 1 vjeçar të nënshkruara çdo vit nga institucioni. Gjithashtu, shoqëria përfiton të ardhura edhe nga interesat bankare të depozitës që ajo ka në bankën “C.”.

Tabela nr. 5: Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2024 si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nipti	Detyrimi mujor	Të ardhurat vjetore
-	Kontrata mbi 200m²			
1	N.AH	K9	111,740	1,210,910
2	KAA	K52	699,180	8,390,160
3	Me	K51	241,000	2,892,000
4	S ShPK	K12	644,940	7,739,280
-	Kontrata nën 200 m²			
5	B.ShPK	J72	24,200	266,200
6	R.E	L22	24,200	290,400
7	A.S	L91	24,200	290,400
8	S.S	M11	24,200	242,000
9	E.S	M3	24,200	290,400
10	H.Gj	L52	24,200	290,400
11	Qira rekuizite			-
12	Interesat bankare			637,753
	Shuma			22,539,903

Burimi i të dhënave: Albafilm

Të ardhurat për vitin 2025 janë parashikuar në vlerën 22,925 mijë lekë, janë realizuar deri në 9-mujor, në vlerën 16,970 mijë lekë, ose në masën 74 % në krahasim me planifikimin vjetor.

-Të ardhurat në total deri në datën 30.09.2025 janë realizuar në masën 99.7 %, sipas projekt programit ekonomik të miratuar janë planifikuar 17,013,540 lekë për tremujorin e tretë dhe janë realizuar 16,970,000 lekë.

Shoqëria realizon të ardhura kryesisht nga dhënia me qira e objekteve, të cilat janë edhe burimi kryesor i të ardhurave. Për vitin 2025 shoqëria ka parashikuar të ardhurat nga 4 subjekte me të cilat ka kontrata me afat 20 vjeçar të cilat janë nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë dhe 6 subjekte me të cilat ka kontrata qiraje me afat 1 vjeçar të nënshkruara çdo vit nga institucioni. Gjithashtu, shoqëria përfiton të ardhura edhe nga interesat bankare të depozitës që ajo ka në bankën “C.”.

Tabela nr. 6: Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2025 si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nipti	Detyrimi mujor	Të ardhurat vjetore
-	Kontrata mbi 200m²			
1	N. AH	K92	111,740	1,005,660
2	K.AA	K52	699,180	6,292,620
3	M.66	K5	241,000	2,169,000
4	S.ShPK	K1	644,940	5,804,460
-	Kontrata nën 200 m²			
5	B. ShPK	J72	24,200	217,800
6	R.E	L2	24,200	217,800
7	A.S	L9S	24,200	217,800
8	R.S	M51	(24,200 + 72,600)	290,800
9	E. S	M31	24,200	217,800
10	H.Gj	L52	24,200	217,800
11	Qira rekuizite			2,200
12	Interesat bankare			315,877
	Shuma			16,969,617

Burimi i të dhënave: Albafilm

Shpërndarja e të ardhurave të krijuara bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu VII “Shpërndarja e të ardhurave” pika 1 dhe 4.

-Të ardhurat që krijohen nga kontrata e qirave të lidhura për pasuri me sipërfaqe deri në 200 m², ndahen 30% buxheti i shtetit dhe 70% institucioni.

-Të ardhurat që krijohen nga kontrata e qirave të lidhura për pasuri me sipërfaqe mbi 200 m², ndahen 10 % buxheti i shtetit dhe 90% institucioni.

-Konstatohet se të ardhurat e shoqërisë në vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me vitin 2023 kanë ardhur në ulje si pasojë e uljes së numrit të subjekteve që kanë ushtruar aktivitet nëpërmjet marrjes me qira të ambienteve nga “Albafilm” SHA.

➤ **Programimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitet 2023, 2024 dhe 2025.**

Albafilm SHA, të ardhurat e krijuara i përdor për paga, shpërblime dhe mbulimin e shpenzimeve operative të nevojshme për funksionimin normal të shoqërisë.

Tabela nr. 7: Plani dhe realizimi i shpenzimeve, paraqitet në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Në 000/lekë

Vitet	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025/9-mujor		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Totali	32,007	25,501	80	22,921	22,667	99	17,865	16,749	94
Shp 600+601	19,469	17,950	92	15,627	15,061	96	10,374	7,307	68
Shp.Op 602	12,537	7,551	60	7,295	7,608	97	7,492	9,442	126

Mallra	127	297	234	182	143	78	192	145	75
Shpe transporti	325	288	88	570	296	52	485	343	71
Shërbime	463	460	99	410	264	64	423	995	70
Tatim taksa	1,102	1,082	98	1,100	1,633	148	1,500	1,475	98
Te ardhura Minist	2,270	2,600	114	2,559	2,558	100	2,559	2,559	100
Ekspert kontabel	400	400	100	350	300	86	350	360	103
Këshilli mbikeq.	1,319	1,426	108	1,624	1,576	97	1,624	1,283	79
Konsulenca	5,500	-	-	0	0	-	0	0	-
Gjoha tatime	571	590	103	0	225	-	0	0	-
Shp.g jyqesore	-	-	-	-	-	-	-	2,273	-
Mirëmbajtje zyra	-	-	-	-	-	-	50	9	18
Amortizimi	460	408	89	450	349	77	450	0	-

Burimi i të dhënave: Albafilm

-Për vitin 2023, shpenzimet në total janë realizuar në masën 80% në krahasim me planifikimin vjetor, zërat e detajuar të shpenzimeve, janë si më poshtë:

➤ **Shpenzime Personeli**

Zëri “Shpenzime Personeli” është realizuar në masën 92%, krahasuar me programin, ku përfshihen shpenzimet për paga, shpërblime dhe kontributin e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.

➤ **Shpenzime Operative**

Zëri “Shpenzime Operative” i programuar në vlerën 12,537 mijë lekë, është realizuar në vlerën 7,551 mijë lekë, ose 60 % krahasuar me parashikimin, ky zë i programit ekonomik përfshin të gjitha kostot që lidhen me funksionimin e veprimtarisë së shoqërisë. Realizimi i 12 mujorit të vitit 2023 paraqet kryesisht shpenzime që lidhen me pagesa të shërbimeve utilitare si ujë, energji elektrike, postë e telekomunikacion si dhe shërbime nga ekspertë të jashtëm.

Megjithëse realizimi i shpenzimeve operative paraqitet në nivelin 60%, konstatohen tejkalime krahasuar me planin vjetor, në zërat “mallra” 234%, “Derdhje të ardhura në Ministri” 114%, “Pagesa Këshilli Mbikëqyrës” 108% dhe “Gjoha e tatime” 103%, si edhe mosrealizim i zërit “shpenzime për konsulencë” i cili nuk është realizuar për vlerën 5.500 mijë lekë.

000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan	Plani ndryshuar
1	Të ardhura gjithsej	25,966	(- 6,280) 19,686
2	Shpenzime gjithsej	25,952	(+ 6,055) 32,007
3	Fitimi bruto	13	(12,320)
4	Fitimi/Humbje neto	11	(12,320)
5	Fondi pagave	16,913	(+ 115) 17,028

Burimi i të dhënave: Albafilm

Ndryshimet në programin ekonomik të vitit 2023, si: shtesa në zërin “Shpenzime gjithsej” në shumën 6,055 mijë lekë, e kërkuar për ekspertizë dhe shërbime ligjore në fushën e kinematografisë, ulje në shumën 6,280 mijë lekë, të zërit “të ardhura gjithsej” dhe shtesë në shumën 115 mijë lekë në zërin “Fondi pagave”, janë kryer sipas relacionit nr.128/21, datë 08.06.2023, për të cilat nuk ka asnjë argumentim ekonomik për rritjen e fondit të pagave, uljen e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve. Zhvillimi i aktivitetit të shoqërisë është planifikuar me humbje si edhe të ardhurat janë planifikuar më të ulta se shpenzimet.

-Për vitin 2024 shpenzimet janë realizuar në masën 99% në krahasim me planifikimin vjetor. Zërat e detajuar të shpenzimeve si më poshtë:

➤ **Shpenzime Personeli**

Zëri “Shpenzime Personeli”, është realizuar në masën 96%, krahasuar me programin, ku përfshihen shpenzimet për paga, shpërblime dhe kontributin e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.

➤ **Shpenzime Operative.**

Zëri “Shpenzime Operative” i programuar në vlerën 7,295 mijë lekë, është realizuar në vlerën 7,608 mijë lekë, ose 97 % krahasuar me parashikimin. Realizimi i 12 mujorit të vitit 2024 paraqet kryesisht shpenzime që lidhen me pagesa të shërbimeve utilitare si ujë, energji elektrike, postë e telekomunikacion si dhe shërbime nga ekspertë të jashtëm. Megjithëse realizimi i shpenzimeve operative paraqitet në nivelin 97%, paraqiten me tejkalim zërat “*Tatim taksa*” 148% dhe “*gjopa nga tatimet*” në vlerën 225 mijë lekë, e cila nuk është planifikuar.

-Për vitin 2025 shpenzimet si 9- mujor, janë realizuar në masën 94% në krahasim me planifikimin vjetor, zërat e detajuar të shpenzimeve, si më poshtë:

➤ **Shpenzime Personeli.**

Zëri “Shpenzime Personeli”, është realizuar në masën 68%, krahasuar me programin, ku përfshihen shpenzimet për paga, shpërblime dhe kontributin e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.

➤ **Shpenzime Operative.**

Zëri “Shpenzime Operative” i programuar në vlerën 7,492 mijë lekë është realizuar në vlerën 9,442 mijë lekë, ose 126 % krahasuar me parashikimin. Realizimi i 9 mujorit të vitit 2025 paraqet tejkalime të shpenzimeve operative ku ndikim ka dhënë zëri “shpenzime gjyqësore” në vlerën 2,273 mijë lekë, i cili nuk është planifikuar dhe me tejkalim rezulton zëri “*pagesa për ekspertë kontabël*” 103%.

Tabela nr. 8: Realizimi në % i shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë

Vitet	2023		2024		2025	
	Fakt	%	Fakt	%	Fakt	%
Totali shpenzimeve	25,501	100	22,667	100	16,749	100
Shp 600+601	17,950	71	15,061	66	7,307	44
Shp.Op 602	7,551	29	7,608	34	9,442	56

Burimi i të dhënave: Albafilm

Shpenzimet për personelin në vitin 2023 ndaj totalit të shpenzimeve zënë 71%, dhe shpenzimet operative në nivelin 29 % .

Shpenzimet për personelin në vitin 2024 ndaj totalit të shpenzimeve zënë 66 %, dhe shpenzimet operative në nivelin 34 % .

Shpenzimet për personelin në 9-mujorin 2025 ndaj totalit të shpenzimeve zënë 44 %, dhe shpenzimet operative në nivelin 56 % .

Shpenzimet në total janë planifikuar në rënie ku ka ndikuar ulja e shpenzimeve të personelit si pasojë e uljes së numrit të punonjësve, largimet nga puna dhe dalje në pension, ndërsa shpenzimet operative dhe niveli që zënë në totalin e shpenzimeve në vitin 2025, paraqiten me rritje krahasuar me vitet 2023 dhe 2024.

Shpenzimet operative për 9-mujorin e vitit 2025 janë realizuar në masën 126 % me një tejkalim

+26%, i cili do të thellohet me mbylljen e vitit 2025.

Konkluzion: Peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve për vitet 2023-2025, e zënë shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve.

-Strukturat drejtuese të “Albafilm” SHA, për ndryshime të konsiderueshme nga plani si në shtesa edhe në pakësime nuk kanë argumentuar rritjen e fondit të pagave, uljen e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve. Zhvillimi i aktivitetit të shoqërisë është planifikuar me humbje si edhe të ardhurat janë planifikuar më të ulta se shpenzimet.

-Relacionet për miratimin e programeve ekonomike të shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës, janë dërguar jashtë afatit (brenda datës 1 Dhjetor të çdo viti), të përcaktuar në udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” Kreu III, pika 2, dhe shkresat e dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

- Nuk është dërguar relacioni vjetor i vitit 2024 sipas urdhrit të MFE nr.125, datë 08.04.2019 “Për raportimin në Këshilla Mbikëqyrës”.

-Strukturat drejtuese të “Albafilm” SHA, për zhvillimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, nuk kanë planifikuar investime për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

-Të ardhurat e shoqërisë në vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me vitin 2023 kanë ardhur në ulje si pasojë e uljes së numrit të subjekteve që kanë ushtruar aktivitet nëpërmjet marrjes me qira të ambienteve nga “Albafilm” SHA.

-Shpenzimet në total janë planifikuar në rënie, ndërsa shpenzimet operative dhe niveli që zënë në totalin e shpenzimeve në vitin 2025, paraqiten me rritje krahasuar me vitet 2023 dhe 2024.

Shpenzimet operative për 9-mujorin e vitit 2025 janë realizuar në masën 126 % me një tejkalim +26%, i cili do të thellohet me mbylljen e vitit 2025.

-Shoqëria “Albafilm” SHA ka dështuar në përmbushjen e misionit për të cilën është krijuar, nga ku si objekt veprimtarie janë 15 objektiva (përfshirë edhe shërbimin e filmit), duke devijuar aktivitetin drejt një shoqërie që realizon të ardhura nga qiratë për objektet të cilat i ka në pronësi por që i kanë kaluar në përdorim operatorëve ekonomikë bazuar në marrëveshjet e qirasë me Ministrinë e Ekonomisë. Objektet e dhëna me qira nga viti në vit janë reduktuar pasi një pjesë e tyre janë privatizuar dhe shoqëria nuk përfiton të ardhura. Të ardhurat vjetore të shoqërisë nuk mjaftojnë as për shpenzime minimale.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi znj. A. P., ish Administrator, znj. G. A. ish drejtor ekonomik, z. E. M. me detyrë Administrator dhe znj. J. C. me detyrë financiere.

2.2. Auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.

Nga auditimi i të dhënave të vena në dispozicion nga Drejtoria e Financës u konstatua që shoqëria Albafilm Sh.a me nipt K81507013J për periudhën në auditim veprimet bankare i ka kryer në Raiffeisen Bank dhe në Credins Bank. Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës për arkëtimet janë arkëtime nga qiratë për objektet e dhëna me qira. Nga verifikimi me zgjedhje i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se: Transaksionet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar dhe të vulosura. Përpilimi i urdhër pagesave të bankës ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si paga, ujë, drita, telefoni, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe

nga punonjësi etj., Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Nga auditimi i dokumentacioni të bankës u konstatua që në muajin mars 2023 është kryer pagesa në R. Bank për detyrimin e tatimit mbi fitimin e vitit 2019. Detyrimi i tatimit mbi fitimin është kryer në bazë të urdhër pagesës së datës 13.03.2023 të gjeneruar nga Drejtoria e Tatimeve. Urdhër pagesa e gjeneruar nga Drejtoria e Tatimeve përmban detyrimin mbi tatim fitimin e vitit 2019 në vlerën 796,617 lekë, gjobë për pagesë të vonuar 175,116 lekë dhe interesa për pagesë të vonuar në vlerën 133,636 lekë.

Pagesa për tatim fitimin e vitit 2019 ka ardhur si pasojë e ndryshimit të deklaratës së tatim fitimit të vitit 2019 me datë 01.03.2023, rrjedhimisht nga ndryshimi i deklaratës së tatim fitimit të vitit 2019 është rritur detyrimi për pagesë i tatim fitimit rrjedhimisht edhe gjobat dhe interesat për pagesë të vonuar.

Pagesa është kryer me datë 21.03.2023 në bazë të urdhër transfertës bankare në vlerën totale 1,108,369 lekë. Për sa me sipër vlera prej 308,752 lekë (175,116+133,636) për pagesat e gjobave dhe kamatëvonesave konsiderohet efekt negativ financiar.

Nga auditimi i dokumentacioni të bankës u konstatua që në bazë të urdhër pagesës së datës 13.03.2023 të gjeneruar nga Drejtoria e Tatimeve është kryer pagesa në R. Bank për detyrimin e tatim fitimit për periudhën tatimore të vitit 2020. Urdhër pagesa e gjeneruara nga Drejtoria e Tatimeve përmban detyrimin mbi tatim fitimin e vitit 2020 në vlerën 792,546 lekë, gjobë për pagesë të vonuar 173,568 lekë dhe interesa për pagesë të vonuar në vlerën 88,249 lekë.

Pagesa për tatim fitimin e vitit 2020 ka ardhur si pasojë e ndryshimit të deklaratës së tatim fitimit të vitit 2020 me datë 01.03.2023, rrjedhimisht nga ndryshimi i deklaratës së tatim fitimit të vitit 2020 është rritur detyrimi për pagesë i tatim fitimit rrjedhimisht edhe gjobat dhe interesat për pagesë të vonuar.

Pagesa është kryer me datë 21.03.2023 në bazë të urdhër transfertës bankare në vlerën totale 1,054,363 lekë. Për sa më sipër vlera prej 261,817 lekë (173,568+88,249) për pagesat e gjobave dhe kamatëvonesave konsiderohet efekt negativ financiar.

Ne total gjoba për pagesë me vonesë dhe kamatëvonesë për pagesat e tatim fitimit të vitit 2019 dhe vitit 2020 janë në vlerën prej 570,569 lekë (308,752 lekë+261,817 lekë).

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua që në vitin 2023 janë paguar gjoba për pagesë me vonesë dhe kamatëvonesë për pagesat e tatim fitimit të vitit 2019 dhe vitit 2020 në vlerën prej 570,569 lekë. Vlera prej 570,569 lekë shpenzime për pagesat e gjobave dhe kamatvonesave konsiderohet efekt negativ financiar sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomikitet. Mos analizimi i arsyeve të pagesave me vonesë të tatimit mbi fitimin dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi në proceset e pagesave me vonesë e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative për shoqërinë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar nëni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, Neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. znj. A. P. ish Administrator i Shoqërisë
2. znj.G. A. ish Drejtor Ekonomik

Nga auditimi i pagesave të kryera në Raiffaisen Bank u konstatua në muajin shtator 2025 janë paguar gjoba për pagesë të vonuar për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Tiranë në vlerën 142,681 lekë sipas urdhër tranfertës bankare datë 18.09.2025.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua në muajin shtator 2025 janë paguar gjoba për pagese të vonuar për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Tiranë në vlerën 142,681 lekë.

Vlera prej 142,681 lekë shpenzime për pagesat e gjobave dhe kamatëvonesave konsiderohet efekt negativ financiar duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomicitet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. z. E. M. Administrator i shoqërisë
2. znj. J. C. Drejtor Ekonomik

Nga auditimi i pagesave të kryera në R. Bank u konstatua që në muajin shkurt 2025 janë paguar 2,274,257 lekë nga ekzekutimi nga përmbarimi në bankë për ish punonjësën A. Gj. nga Zyra e përmbarimit Privat “E. G.”. Sipas dokumentave të vendosura në dispozicion nga specialistja e financës znj. J.C. shoqëria Alba Film sha është njoftuar me shkresën nr.26/1 datë 20.01.2025 me nr.regj.2466 protokolluar në shoqërinë Albafilm sha me nr11/2.prot., datë 23/01/2025 me objekt “*Lajmërim për ekzekutim vullnetar*” për pagim page për punonjësën A. Gj. Detyrimi për 15 paga x 138,209 lekë = 2,073,135 lekë shpenzime gjyqësore 99,975 lekë dhe tarifa përmbarimore 100,397 lekë.

Me shkresën nr. 3309/1 datë 05.02.2025 e protokolluar në shoqërinë Albafilm me nr.11/9.prot., datë 06.02.2025 është njoftuar Albafilm për bllokimin e llogarive bankare në C. Bank në zbatim të urdhrit të përmbaruesit A. L.

Me emalin e datës 31.01.2025 Albafilm sha është njoftuar për bllokimin e llogarive bankare në R. Bank sipas urdhrit të sekuestros konservative nr.26/3 me nr.2466.regj datë 29.01.2025 nga Zyra e përmbarimit Privat “E. G.” për vlerën 2,274,257 lekë.

Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësi administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave të vendimeve gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhetin e shoqërisë. Vlera prej 2,274,257 lekë shpenzime për vendime gjyqësore për largimet nga puna konsiderohet efekt negativ financiar duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomicitet.

Konkluzion: Nga auditimi i pagesave të kryera në R. Bank u konstatua që në muajin Shkurt 2025 janë paguar 2,274,257 lekë nga ekzekutimi nga përmbarimi në bankë për ish punonjësën A.Gj. Vlera prej 2,274,257 lekë shpenzime për vendime gjyqësore për largimet nga puna konsiderohet efekt negativ financiar duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomicitet. Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e

përgjegjësi administrative, ndikon negativisht për korrëgjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave të vendimeve gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhetin e shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, Neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës:

Nga verifikimi me zgjedhje i periudhave në lidhje me veprimet me arkë konstatohet se:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e arkës në bazë të arkëtimeve dhe pagesave të kryera nga shoqëria Albafilm sha. Për arkëtimet dhe pagesat është mbajtur libri dhe ditari i arkës.

Për periudhën në auditim rezulton se shoqëria Albafilm sha nuk ka shumë veprime me arkë. Për vitin 2023 ka vetëm një mandat arkëtimi sipas ditarit të arkës me vlerë 71,650 lekë që janë të ardhura nga qiratë dhe 18 mandat pagesa për vlerën 71,870 lekë që janë shërbime postare, interneti, pagesë për nënshkrimin elektronik, ujë, etj. Nga 18 mandat pagesa një mandat pagese është derdhje në bankë në vlerën 40,000 lekë me nr.7 datë 07.04.2023. Nga auditimi i ditarit të arkës u konstatua se nga 18 mandat pagesa 9 mandat pagesa janë mbi 1,000 lekë.

Për vitin 2024 ka vetëm një mandat arkëtimi sipas ditarit të arkës me vlerë 24,200 lekë që janë të ardhura nga qiratë dhe 9 mandat pagesa për vlerën 26,065 lekë që janë shërbime postare, pagesë për nënshkrimin elektronik, pagesë taksë automjeti etj. Nga auditimi i ditarit të arkës për vitin 2024 konstatohet se nga 9 mandat pagesa 6 mandat pagesa janë mbi 1,000 lekë. Për vitin 2024 mandat pagesat janë firmosur nga znj.G. A. dhe nga znj.D. M. si dhe punonjësi që ka kryer pagesën sipas rastit. Për vitin 2024 konstatohet që nuk janë firmosur nga znj.G. A. 6 mandat pagesa konkretisht me nr.03. date 16.05.2024 me vlerë 1,620 lekë me nr.4 datë 16.05.2024 me vlerë 970 lekë, me nr.5 datë 28.06.2024 me vlerë 840 lekë, me nr.6 date 28.06.2024 me vlerë 3,500 lekë me nr.7 datë 01.07.2024 me vlerë 4,980 lekë me nr.8 datë 30.08.2024 me vlerë 1,315 lekë me nr.9 datë 12.09.2024 me vlerë 10,660 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i ditarit të arkës u konstatua në vitin 2023 ka vetëm një mandat arkëtimi sipas ditarit të arkës me vlerë 71,650 lekë që është mbi vlerën 1,000 lekë.

Për vitin 2024 konstatohet se nga 9 mandat pagesa, 6 mandat pagesa janë mbi 1,000 lekë. Për vitin 2024 mandat pagesat janë firmosur nga znj.G. A. dhe nga znj.D. M. si dhe punonjësi që ka kryer pagesën sipas rastit. Për vitin 2024 konstatohet që nuk janë firmosur nga znj.G. A. 6 mandat pagesa.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” Neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 64 dhe pika 68.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. znj.G. A. ish Administrator i shoqërisë.

2. znj. D. M. ish Drejtor Ekonomik.

Për vitin 2025 ka vetëm dy mandat arkëtimi sipas ditarit të arkës me vlerë 2,200 lekë qira ditore veshje dhe 72,600 lekë që janë të ardhura nga qiratë. Për periudhën 01.01.2025 deri 30.09.2025 janë 12 mandat pagesa për vlerën 74,290 lekë që janë shërbime postare, pagesë për nënshkrimin elektronik, pagesë taksë automjeti etj. Nga 12 mandat pagesa një mandat pagese është derdhje nga arka në bankë me vlerë 53,300 lekë me nr.5 datë 03.03.2025. Nga auditimi i ditarit të arkës për vitin 2024 konstatohet se nga 12 mandat pagesa 5 mandat pagesa janë mbi 1,000 lekë.

Për periudhën në auditim 01.01.2025-30.09.2025 u konstatua që të gjitha mandat pagesat nuk ishin të firmosura nga nëpunësi autorizues për neglizhence.

Furnizimi me dokumente për arkëtime dhe pagesa (mandat arkëtime dhe mandat pagesa), është kryer nga persona të rastësishëm shitës dhe jo nga shtypshkronja e letrave me vlerë. Mandat arkëtimet e përdorura nuk kanë numër serie të para shtypur. Përdorimi i këtyre dokumenteve që nuk përmbushin standardet ligjore për përdorim në sektorin publik ka risk të lartë që ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin” neni 6/ç, 12/dh dhe Vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, pika 1 dhe pika 2.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, Neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 64 dhe pika 68.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. z. E. M. Administrator i shoqërisë.
2. znj. J. C. Drejtor Ekonomik.

3. Auditim mbi evidencën kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij nga organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese 2023-2024.
- Ditarët e kontabilitetit për periudhat raportuese ushtrimore 2023-2024.
- Listë pagesat me përzgjedhje për periudhat raportuese ushtrimore 2023-2024.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhat raportuese ushtrimore 2023-2024.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit, për vitin ushtrimor 2023-2024.
- Dokumentet e inventarizimit etj., për vitin ushtrimor 2023-2024.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2023-2024

Në fund të periudhës ushtrimore, pasqyrat financiare janë plotësuar sipas ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Pasqyrat financiare për vitin 2023 janë përgatitur nga znj. D. M. me detyrë drejtor i financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Administratori i Komanduar i Albafilm Sh.a, znj. G. A. Pasqyrat financiare janë dorëzuar në datën 16.02.2024, brenda limiteve të përcaktuara në ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Për vitin 2024 pasqyrat financiare janë përgatitur nga znj. J. C. me detyrë drejtor i financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Administratori i Albafilm Sh.a, z. E. M. Pasqyrat financiare janë dorëzuar në datën 21.03.2024, brenda limiteve të përcaktuara në ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Veprimet kontabël janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht ditarët analitikë të të gjitha llogarive, përfshirë llogaritë inventariale të magazinës, për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Format 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Format 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Format 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Format 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Format 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **413 mijë lekë** për shpenzimet dhe **374 mijë lekë** për të ardhurat, sipas **aneksit nr. 2/3/1** e paraqitur në anekset e raportit të auditimit:

Për vitin 2024 marrë në konsideratë vlerën e precizionit **367 mijë lekë** për shpenzimet dhe **368 mijë lekë** për të ardhurat, sipas **aneksit nr. 2/3/2** e paraqitur në anekset e raportit të auditimit:

➤ Bazat e përgatitjes:

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë hartuar dhe paraqitur sipas Standarteve Kombëtare të Përmirësuara dhe Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar.

Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Vijmësia

Pasqyrat financiare janë hartuar mbi parimin e vijmësisë së veprimtarisë ekonomike të njësisë raportuese duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.

Monedha raportuese dhe funksionale

Pasqyrat financiare paraqiten në lekë e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktivet e detyrimit e kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste drejtimi mbështetet në mendimin e ekspertëve të pavarur. Drejtimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të bazohen me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (rregullime) material, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë.

Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrim, vlerësimin e aftësive paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlërësimin e llogarive të arkëtueshme.

Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodh që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

➤ Politika kryesore kontabël.

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1. Monedhat e huaja

Transaksionet e kryera në monedhë të huaj janë konvertuar në lekë me kursin e ditës së kryerjes së transaksionit. Ndërsa gjendjet e llogarive të mjeteve dhe detyrimeve në monedhë të huaj janë konvertuar në lekë më kursin zyrtar në ditën e fundit të vitit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

Diferencat nga kurset e këmbimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në kohën kur ndodhin.

Kursi i shpallur nga Banka e Shqipërisë në 31 dhjetor, sipas monedha përkundrejt lekut.

Monedha	31.12.2024	31.12.2023
EUR	98.15	103.88
USD	94.26	93.94

2. Aktivet afatgjata materiale

I. Njohja dhe matja

AAM janë paraqitur me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kosto është vlera e blerjes plus kosto të tjera të drejtëpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të shoqërisë.

Të ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivi (llogaritur si diferencë midis arkëttimeve nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivit (njihen si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitim humbjeve.

Kostoja e zëvendësimit të aktiveve afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do ti vijjnë shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri.

Kostoja e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

II. Kostot e mëvonshme.

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihen në vlerën kontabël të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme brenda pjesës do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e shërbimeve të pronës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

III. Amortizimi.

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga data e vendosjes në punë.

Amortizimi vjetor i AAM-ve është llogaritur me metodën e vlerës së mbetur me normat e mëposhtme të amortizimit.

Aktive Afatgjata Materiale	Norma e Amortizimit
Toka	n/a
Ndërtesa	5%
Mjete Transporti	20%
Pajisje Kompjuterike	25%
Makineri dhe Pajisje	20%
Pajisje Zyre	20%
AAM të tjera	20%

IV. Çregjistrimi:

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohen kur nxirret jashtë përdorimit ose kur priten përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi ose nxjerrja jashtë përdorimit. Fitimet dhe

humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve fikse llogariten në bazë të shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në llogaritjen e fitimit operativ në vitin fiskal.

3. Aktivet Afatgjata Jomateriale (AAJM)

Aktivitet jo materiale, njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka. Amortizimi shpërndahet duke përdorur metodën e amortizimit mbi vlerën e mbetur. Norma e amortizimit për aktivet afatgjata jo materiale është 25%. Jeta e dobishme e vlerësuar dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese vjetore, duke njohur në periudhat pasuese efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël.

4. Inventarët

Inventarët vlerësohen fillimisht me koston e blerjes, përfshirë të gjitha shpenzimet e lidhura drejtpërdrejtë me blerjen e tyre. Kosto është përcaktuar duke përdorur metodën e çmimit mesatar të ponderuar. Vlera e inventarëve rishikohet çdo fundviti dhe i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

5. Instrumentat financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera mjete monetare në arkë dhe bankë, jua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë:

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

-Mjetet Monetare:

Mjetet monetare përfshijnë, paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në bankat tregtare vendase. Overdraftet bankare përfshihen nën zërin hua financiare, tek detyrimet afatshkurtra të pasqyrës së pozicionit financiar.

-Llogari të arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohet tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesat.

-Llogaritë e pagueshme:

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesat efektiv.

-Huat e marra dhe të dhëna:

Huatë financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit, njohja e mëpasshme bëhet me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve diferencën midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale gjatë periudhës së huasë bazuar në interesin efektiv.

-Zhvlerësimi i aktiveve financiare:

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur produktet dhe shërbimet janë përfunduar, kryer risqet dhe përfitimet janë transferuar.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat janë matur me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh çdo zbritje të lejuar nga shoqëria.

Të ardhurat nga qiraja njihen përgjatë kohëzgjatjes së qirasë, në periudhat me të cilat lidhen.

Të ardhurat e tjera nga aktivitetet operative paraqesin të ardhurat e përfituara jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të aktivitetit ekonomik duke përfshirë: fitim/humbjen nga shitja e aktiveve materiale ose jo materiale, fitim/humbjen nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale dhe fitim/humbjen që lindin nga diferencat e kursit të këmbimit të ndryshme nga ato diferenca që rrjedhin nga investimet dhe aktivitetet financiare.

7. Qiratë

Qiratë klasifikohen si financiare ose operative që në fillim. Qiratë klasifikohen si qira financiare kurdoherë kur termat e qirasë transferojnë nga qiradhënësi te qiramarrësi në mënyrë domethënëse të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit. Të gjitha qiratë e tjera, klasifikohen si qira operationale. Pagesat e bëra për qiranë operationale, ngarkohen në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve sipas kushteve të qirasë.

8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet në valutë të huaj. Të ardhurat nga interesi njihen ashtu siç rrjedhin, duke përdorur metodën e interesat efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet, humbjet në valutë të huaj dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivitetet financiare.

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur efektivin metoda e interesit.

9. Tatim fitimi

Tatimi aktual është tatimi i pritur për tu paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Norma e aplikuar për tatimin mbi fitimin është 15%. Sipas legjislacionit fiskal në fuqi, shoqëria ka të drejtë të zbresë humbjen e mbartur tatimore duke filluar nga vitit 2024, në pesë vitet e ardhshme radhazi, nëse pronësia nuk ndryshon me shumë se 50%.

10. Përfitimet e punonjësve

Gjatë aktivitetit të saj normal, shoqëria kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet e sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të shoqërisë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

11. Dividentët

Dividentët njihen si detyrime në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën aprovohet shpërndarja nga asambleja e aksionarit të vetëm.

12. Palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Transaksionet me palët e lidhura janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare.

➤ Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023-2024:

Mjetet Monetare:

Mjetet monetare në bankë dhe arkë në 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqiten si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Mjete monetare	-	-
Llogari rrjedhëse në lekë	13,805,779	13,082,712
Para në arkë	<u>1,190</u>	<u>3,055</u>
	13,806,969	13,085,767

Shoqëria Albafilm Sh.a operon me 2 banka në Republikën e Shqipërisë, R. Bank dhe C. Bank.

Tabela nr. 9: Llogaritë bankare të Albafilm në mbyllje të vitit 2023

Nr	Emri i Bankës	Monedha	Vlera në lekë
1	Raiffeisen Bank	lekë	12,928,076
2	Veneto Bank	lekë	6,926
3	Credins Bank (Depozite)	lekë	25,000,000
4	Credins Bank	lekë	147,710
Total			38,082,711

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit të Bankës u verifikua si më poshtë:

-Referuar lëvizjes së llogarisë në R. Bank të datës 30.01.2024 për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 gjendja në fund është në vlerën 12,928,075 lekë.

-Referuar lëvizjes së llogarisë në C. Bank të datës 30.01.2024 për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 gjendja në fund është në vlerën 147,709 lekë.

Tabela nr. 10: Llogaritë bankare të Albafilm në mbyllje të vitit 2024

Nr	Emri i Bankës	Monedha	Vlera në lekë
1	R. Bank	lekë	11,160,378
2	V. Bank	lekë	6,926
3	C. Bank (Depozite)	lekë	25,000,000
4	C. Bank	lekë	2,638,475
Total			38,805,779

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit të Bankës u verifikua si mëposhtë:

-Referuar lëvizjes së llogarisë në R. Bank të datës 13.01.2025 për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 gjendja në fund është në vlerën 11,160,378 lekë.

-Referuar lëvizjes së llogarisë në C. Bank të datës 13.01.2025 për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 gjendja në fund është në vlerën 2,638,475 lekë.

-Referuar lëvizjes së depozitës në C. Bank të datës 20.03.2025 për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 gjendja në fund është në vlerën 25,000,000 lekë.

Të drejta nga aktiviteti i shfrytëzimit:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Klientë mbi një vit	7,746,811	7,746,811
Klientë	156,227	2,057
Paradhënie personeli	470,120	470,120
Debitorë të tjerë	-	1,375
	8,373,158	8,220,363

Llogaria “Klientë mbi një vit” e cila është kontabilizuar në vlerën 7,746,811 lekë nuk është e analizuar analitikisht. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me nenin 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Të drejta të tjera:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Të tjera kërkesa	26,554,935	26,554,935
Tatim fitimi	1,199,733	1,209,733
Tatim mbi vlerën e shtuar	15,994	25,994
	27,770,662	27,790,662

Të tjera të arkëtueshme në shumën 26,555 mijë lekë janë kërkesa ndaj ish-punonjësve ose palëve të treta të nxjerra nga auditimet e KLSH-së dhe nga vendimet gjyqësore.

Kjo vlerë është e pandryshuar prej vitit 2019 dhe është kontabilizuar me kundërpartit zërin të ardhura të shtyra të paraqitur në detyrimet afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar.

Tabela nr.11: Debitorët e kontabilizuar

Nr	Debitorët	Gjendja 01.01.2023	Gjendja 31.12.2024
----	-----------	--------------------	--------------------

1	Tv B	1,083,774	1,083,774
2	N.AH	16,860	16,860
3	A.D.	5,122,390	5,122,390
4	B. Gj.	20,000	20,000
5	K.F	81,595	81,595
6	N	703,322	703,322
7	B.H.	10,530	10,530
8	T.L.	50,340	50,340
9	M. K.	483,190	483,190
10	D&	9,360	9,360
11	V.R.	9,501	9,501
12	A.D.	25,567	25,567
Totali		7,616,429	7,616,429

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar kontabilizimit në llogarinë 46 “Debitorë dhe kreditor të ndryshëm” është paraqitur në vlerën 26,554,935 lekë nga analiza e paraqitur analitikisht disponohet informacion për 12 debitorë me vlerë detyrimi 7,616,429 lekë. Diferenca prej 18,938,506 lekë nuk shoqërohet me dokumentacion justifikues në kundërshtim me nenin 7 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Inventarët:

Inventarët në 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Inventar (arkiva filmit dhe rekuizitë)	574,995,679	574,995,679
Materiale ndihmëse	1,681,090	1,637,908
Lëndë djegëse	24,180	-
Materiale ambalazhimi	48,050	48,050
Objekte inventari	64,593	64,593
Zhvlerësim inventari	(524,768)	(524,768)
	576,288,824	576,221,462

Referuar SKK 4 “Inventarët” duhet ti nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit. Shoqëria Albafilm gjatë vitit 2023 dhe 2024 nuk ka kryer testimin e zhvlerësimit në kundërshtim me SKK 4.

Gjatë vitit 2024, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e Titullarit të Shoqërisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.64 datë 04.11.2024 për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të shoqërisë. Sipas urdhrin të mësipërm inventari i aktiveve do të zhvillohet deri në 31.12.2024.

Urdhëri nr. 64 datë 04.11.2024 për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve për vitin 2024 të Shoqërisë Albafilm.

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka në përbërje:

1-A.C.

2-G.H.

3-E.B.

Me urdhrin e brendshëm nr.65, datë 25.11.2024 nga komisioni largohet znj. E. B dhe zëvendësohet me znj. R. S.

Nga inventarizimi grupi i vlerësimit ka rekomanduar në relacion për inventarët e magazinës së kostumërisë ushtarake, magazinës së kostumërisë civile të ngrihet një grup pune me njohuri nga fusha e kostumografisë për të identifikuar se cilat janë prej tyre të amortizuara dhe duhet të nxirret jashtë përdorimit pasi edhe pse mund të jenë të vjetëruara ato kanë vlera historike.

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi sipas relacionit të mbajtur ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit kontabël të hartuara nga financa.

Tabela nr.12: Inventarizimi i asetëve

Nr	Institucioni	Gjendja Kontabël	Gjendja Fizike
1	Sh.M	961,065	961,065
2	M. F	563,349,959	563,349,959
3	M. R	4,601,924	4,601,924
4	M. K.U	4,135,424	4,135,424
5	M.K.C.	5,916,475	5,916,475
6	Z.J	545,463	545,463
7	Z.F	654,975	654,975
8	R.A	520,823	520,823
9	M. R	5,839,191	5,839,191
10	Z.A	5,748,754	5,748,754
11	D.E	360,195	360,195
12	M. R	113,507,750	113,507,750
13	Z	142,370	142,370
14	Z	810,315	810,315
15	N.I	2,626,911	2,626,911
16	Z	382,476	382,476
17	Z	95,310	95,310

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Për mjetet e transportit rekrizitë midis Shoqërisë Albafilm dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor është lidhur aktmarrëveshje me nr.184/1 prot., datë 21.09.2022 për 13 mjete të cilat do të mbahen vetëm në ruajtje nga DPSHTR në ambientet e kësaj Drejtorie. Afati i marrëveshjes është 1 vit nga data e nënshkrimit. Nga data 21.09.2023 deri në datën 31.12.2024 sipas procesit të inventarizimit këto mjete ndodhen në ambientet e DSHPTR pa 1 kontratë për mbajtjen e këtyre mjeteve.

Aktive të tjera financiare:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Depozitë C. Bank në lekë	25,000,000	25,000,000
	25,000,000	25,000,000

Shoqëria Albafilm ka lidhur me C. Bank në datën 09.05.2016, kontratë për vendosje depozitë me afat maturimi 5 vjecar në vlerën 25 milion lekë, me rinovim automatik. Në datën e rinovimit zbatohet norma e interesat në fuqi, sipas kushteve të bankës. Gjatë vitit 2024, janë përfituar interes nga depozita me normë vjetore 3%.

Tituj të tjerë të huadhënies:

Tituj të tjerë të huadhënies në 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Hua Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit në lekë	13,708,800	13,708,800
	13,708,800	13,708,800

Bazuar në vendimin e Këshillit të Mbikëqyrjes, Nr.6, datë 16.05.2023 shoqëria ka lidhur një marrëveshje me datë 16.05.2023, shoqëria Arkivi Qëndror i Filmit, për transferimin e fondeve në vlerën 13,708 mijë lekë.

Qëllimi i lëvrimit të fondit është finalizimi nga AQSHF i projektit të saj: Recon-Re-valuation of Cultural Heritage, Knowledge and Opportunity Network. Fondet e dhëna janë pa interes dhe me afat maturimi me datë 31.12.2023.

Shoqëria Albafilm Sh.a i është drejtuar me shkresën nr.19/4 prot, datë 26.11.2024 Arkivit Qëndror Shtetëror të Filmit me qëllim transferimin e shumës 13,708,800 lekë.

Arkivi Qëndror Shtetëror i Filmit me shkresën nr.159/1 prot, datë 13.12.2024 ka kthyer përgjigje shkresës nr.9/4, datë 26.11.2024 duke informuar se projekti Recon ka përfunduar dhe është certifikuar për AQSHF dhe janë në pritje të rimbursimit.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM):

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 195,725 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 165,196 lekë, shtesa gjatë vitit 2024 në vlerën 0 lekë, amortizim i vitit 2024 në vlerën 4,579 lekë dhe vlerë neto në vlerën 25,950 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në këtë llogari është kontabilizuar vetëm 1 program.

Aktivet Afatgjata Materiale:

Llogaritë e Klasës 2 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024, paraqiten në shumën 336,757,052 lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 337,101,494 lekë. Gjatë viti 2024 nuk kemi patur shtesë të AAM-ve. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 kanë qenë në vlerën 344,441 lekë.

Në aneksin nr. 2/3/3 në anekset e raportit të auditimit janë pasqyruar Aktivet Afatgjata Materiale me kosto historike, amortizim të akumuluar dhe vlerën neto kontabël.

Llogaria 210 “Toka, troje terrene” është paraqitur në bilanc në vlerën 334,411,619 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2024 dhe është rregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 334,411,619 lekë.

Në aneksin nr. 2/3/4 në anekset e raportit të auditimit janë pasqyruar AAM në pronësi gjatë vitit 2023.

Në aneksin nr. 2/3/5 në anekset e raportit të auditimit janë pasqyruar AAM në pronësi gjatë vitit 2025.

Në aneksin nr. 2/3/6 në anekset e raportit të auditimit janë pasqyruar AAM të dhëna me qira.

Kjo llogari është e kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv i vetëm me sipërfaqje 15,487 m².

Ky veprim është në kundërshtim me SKK 5(i përditësuar), Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale pikat 8 dhe 11 dhe Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Aktivet duhet të kontabilizohen në këtë llogari sipas dokumentit ligjor.

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” është paraqitur në bilanc në vlerën 567,826 lekë në fund të vitit 2023. Gjatë vitit 2024 amortizimi është në vlerën 28,391 lekë dhe vlera kontabël neto 539,435 lekë.

DETYRIMET DHE KAPITALI:

Të ardhura të shtyra:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Të ardhura të shtyra në lekë	27,025,055	27,025,055
	27,025,055	27,025,055

Llogaria “Të ardhura të shtyra” e cila është kontabilizuar në vlerën 27,025,055 lekë nuk është e analizuar analitikisht. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me nenin 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Furnitorët mbi një vit	4,157,701	4,157,701
	4,157,701	4,157,701

Detyrime Tatimore:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Sigurime Shoq & Shëndetësore	279,811	333,528
Tatim mbi të ardhurat personale	78,271	130,384
Tatim në burim	33,413	31,000
	391,495	494,912

Llogari të pagueshme të tjera:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Detyrime ndaj MEKI	3,818,837	3,179,099
Detyrime të tjera	4,400	-
Furnitorë të tjera	5,222	-
	3,828,459	3,179,099

Kapitali i nënshkruar:

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 847,490,000 lekë dhe zotërohet 100% nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Gjatë vitit 2024 nuk ka ndryshime në kapitalin e nënshkruar.

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Kapitali i nënshkruar	847,490,000	847,490,000
	847,490,000	847,490,000

Rezervat:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Gjendje në fillim	121,254,999	118,836,343
Korrigjime të periudhave të mëparshme	-	1,213,325
Transferim nga fitimi i vitit 2022	-	1,205,331
Gjendje në fund	121,254,999	121,254,999

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET:

Të ardhurat:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Të ardhura qira	22,056,320	22,241,620
Të ardhura nga qira rekuizite	-	63,700
	22,056,320	22,305,320

Të tjera të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Interesa nga depozita	750,000	750,000
Tatim i mbajtur në burim depozita	-	(112,545)
	637,753	750,000

Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Blerje të tjera	464,060	49,639
Tatim i mbajtur në burim depozita	(67,362)	247,746
	396,968	297,385

Të tjera shpenzime:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Tarifa për MEKI	2,558,952	2,600,022
Këshilli Mbikëqyrës	1,577,585	1,426,132
Taksa lokale	1,633,052	1,082,212
Shërbime auditimi	300,000	400,000
Shpenzime të tjera personeli	187,454	623,714
Shpenzime të tjera	255,399	314,500
Energji	100,382	85,951
Uje	16,764	38,672
Komisione Bankare	49,775	61,119
Komunikimi	35,775	71,799
Mirëmbajtje dhe riparime	35,000	-
Shpenzime mjete transporti	29,600	27,744
Gjoha dhe dëmshpërblime	22,474	590,112
	6,861,313	7,262,875

Vendimet Gjyqësore.

Gjatë periudhës 2023-2025, Shoqëria Albafilm ka disa çështje gjyqësore të hapura me punonjës të larguar dhe palë të tjera të treta. Shoqëria nuk ka përlogaritur provizionet për humbje të mundshme nga këto çështje gjyqësore e cila është në kundërshtim me *SKK 6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara", paragraph 24-25, SNK 37, "Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit për provizionet, detyrimet dhe aktet e kushtëzuara*

Tabela nr.13: Vendimet gjyqësore gjatë vitit 2023

Viti	Paditësi	Gjykata	Objekti i paditës
2023	Sh. Shpk	Shkalla e I	Kontratë qiraje
2023	L.C	Apeli	Padi për marrëdhënie pune
2023	A.P	Shkalla e I	Padi për marrëdhënie pune

Burimi: Albafilm**Tabela nr.14:** Vendimet gjyqësore gjatë vitit 2024

Viti	Paditësi	Gjykata	Objekti i paditës	Statusi Aktual
2024	F.H	Shkalla e I	Pretendim për truallin në pronësi të Shoqërisë Albafilm	
2024	A.P.	Shkalla e I	Padi për marrëdhënie pune	
2024	AA	Shkalla e I	Kontratë Qiraje	Pushuar 2025
2024	AH	Shkalla e I	Kontratë Qiraje	Pushuar 2025
2024	A.Gj	Shkalla e I	Padi për marrëdhënie pune	Paguar 2,273,507 lekë, (ekzekutim i përkohshëm)

Burimi: Albafilm**Tabela nr.15:** Vendimet gjyqësore gjatë vitit 2025

Viti	Paditësi	Gjykata	Objekti i paditës	Statusi Aktual
2025	F.H	Shkalla e I	Pretendim për truallin në pronësi të Shoqërisë Albafilm	
2025	A.P	Apeli	Padi për marrëdhënie pune	
2025	A.Gj	Shkalla e I	Padi për marrëdhënie pune	Paguar 2,273,507 lekë, (ekzekutim i përkohshëm)
2025	A.S	Shkalla e I	Padi për marrëdhënie pune	

Burimi: Albafilm

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancën financiare” të PF të vitit 2024 paraqitet në **aneksin nr. 2/3/7** në anekset e raportit të auditimit.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Strukturat drejtuese të “Albafilm” SHA, nuk kanë argumentuar ndryshimet e konsiderueshme të programit ekonomik, si në shtesa edhe në pakësime për vitin 2023, e shfaqur në rritjen e fondit të pagave, rritjen e numrit të punonjësve, uljen e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve. Rezultati i aktivitetit të shoqërisë është planifikuar me humbje, pasi të ardhurat janë planifikuar më të ulta se shpenzimet.

- Relacionet për miratimin e programeve ekonomikë të shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës, janë dërguar jashtë afatit, të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kreu III, pika 2, si dhe shkresat e dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

- Strukturat drejtuese, për zhvillimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, nuk kanë planifikuar investime për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

- Peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve të shoqërisë 65-71%, për vitet 2023 - 2025, e zënë shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve.

- Të ardhurat e shoqërisë në vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me vitin 2023 kanë ardhur në ulje, si pasojë e uljes së numrit të subjekteve që kanë ushtruar aktivitet nëpërmjet marrjes me qira të

ambienteve në pronësi të “Albafilm” SHA.

- Shpenzimet në total janë planifikuar në rënie, ndërsa ato operative dhe pesha që zënë në totalin e shpenzimeve në vitin 2025, paraqiten me rritje krahasuar me vitet 2023 dhe 2024.

Shpenzimet operative për 9-mujorin e vitit 2025 janë realizuar në masën 126 % me një tejkalim + 26%, i cili do të thellohet me mbylljen e vitit 2025. Tejkalmi i shpenzimeve operative paraqitet në zërat “Shërbime”, “Tatim taksa”, “Pagesa e detyrimeve ndaj Ministrisë” dhe “Shpenzime gjyqësore”.

- Shoqëria ka dështuar në përmbushjen e misionit për të cilën është krijuar, ku si objekt veprimtarie janë 15 objektiva si: servisi i filmit artistik, ofrimi i shërbimeve në fushën e artit, realizimi i investimeve për prodhimin, përpunimin, shpërndarjen e produkteve artistike, veprimtari në fushën e marketingut, festivale, kinematografi etj. Shoqëria ka devijuar aktiviteti drejt një shoqërie që realizon të ardhura vetëm nga qiratë për objektet të cilat i ka në pronësi, por që i kanë kaluar në përdorim operatorëve ekonomikë bazuar në marrëveshjet e qirasë me Ministrinë e Ekonomisë. Objektet e dhëna me qira nga viti në vit janë reduktuar, pasi një pjesë e tyre janë privatizuar dhe shoqëria nuk përfiton të ardhura. Të ardhurat vjetore të shoqërisë nuk mjaftojnë as për shpenzime minimale si shpenzimet operative etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-21 të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin në analizë situatën ekonomike-financiare në të cilën ndodhet shoqëria “Albafilm”, të hartojnë programe ekonomike për zhvillimin dhe rritjen e aktivitetit, të parashikojnë plan për investime sipas prioriteteve të zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë, referuar kapaciteteve dhe nevojave reale të tyre, me qëllim arritjen e objektivave, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës ekonomike.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ditarit të arkës u konstatua se për vitin 2024 nuk janë firmosur nga administratori 6 mandat pagesa. Për vitin 2025 u konstatua që të gjitha mandat pagesat nuk ishin të firmosura nga nëpunësi autorizues. Furnizimi me dokumente të përdorura për arkëtime dhe pagesa (mandat arkëtime dhe mandat pagesa), është kryer nga persona të rastësishëm shitës dhe jo nga shtypshkronja e letrave me vlerë. Mandat arkëtimet e përdorura nuk kanë numër serie të para shtypur. Përdorimi i këtyre dokumenteve që nuk përmbushin standardet ligjore për përdorim në sektorin publik ka risk të lartë që ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”; Udhëzimi i MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 64 dhe pika 68. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-28 të Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa që veprimet e kryera për arkëtimet dhe pagesat që kryhen nëpërmjet arkës të përdoret dokumentacion me numër serie të para shtypur si dhe të nënshkruhen konform legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i regjistrimeve kontabël rezultuan mangësi në analizimin analitik dhe dokumentimin e disa llogarive kontabël, konkretisht në llogaritë “Klientë mbi një vit”, “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm” dhe “Të ardhura të shtyra”.

Llogaria “Klientë mbi një vit”, e kontabilizuar në vlerën 7,746,811 lekë, nuk është e analizuar në mënyrë analitike sipas klientëve dhe afateve përkatëse. Gjithashtu, llogaria 46 “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm” është kontabilizuar në vlerën 26,554,935 lekë, ndërkohë që analiza analitike e disponueshme përbëhet nga 12 debitorë me vlerë 7,616,429 lekë, ndërsa për diferencën prej 18,938,506 lekë nuk është paraqitur dokumentacion justifikues dhe analizë përkatëse. Po ashtu, llogaria “Të ardhura të shtyra”, e kontabilizuar në vlerën 27,025,055 lekë, nuk është e analizuar në mënyrë analitike.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, pikat 1 dhe 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 28-41 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për kryerjen e analizimit analitik të plotë dhe sigurimin e dokumentacionit justifikues për llogaritë “Klientë mbi një vit”, “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm” dhe “Të ardhura të shtyra”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 334,411,619 lekë në fund të vitit 2023 dhe e njëjta vlerë është pasqyruar edhe në fund të vitit 2024, pa ndryshime gjatë vitit ushtrimor.

Kjo llogari është kontabilizuar si një aktiv i vetëm, me një sipërfaqe totale prej 15,487 m², pa u ndarë analitikisht sipas pasurive përkatëse dhe dokumentacionit ligjor që vërteton të drejtat e pronësisë. Aktivet duhet të kontabilizohen në këtë llogari sipas dokumentit ligjor.

Ky veprim është në kundërshtim me SKK 5 (i përditësuar), Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale pikat 8 dhe 11 dhe Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 28-41 të Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për ndarjen dhe kontabilizimin analitik të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” sipas çdo pasurie individuale dhe dokumentit ligjor përkatës

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare shoqëria “Albafilm” SHA nuk ka zbatuar një politikë për zhvlerësimin e inventarit gjatë periudhës 2023-2024. Si pasojë, nuk është e mundur të vlerësohet ndikimi i ndonjë korrigjimi të mundshëm në pasqyrat financiare për këto vite, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë dhe besueshmërinë e vlerës së inventarit të raportuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me SKK “Inventarët”, kapitull zhvlerësimi i inventarëve pikat 28-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 28-41 të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës duhet të kryejë testin e zhvlerësimit për inventarët në datën e raportimit, për të siguruar që pasqyrat financiare të pasqyrojnë saktë vlerën e inventarit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, shoqëria “Albafilm” SHA ka disa çështje gjyqësore në proces me punonjës të larguar dhe palë të tjera të treta. Shoqëria nuk ka përllogaritur provigjionet për humbje të mundshme nga këto çështje gjyqësore, e cila është në kundërshtim me SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”, paragraph 24-25, SNK 37, “Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit për provizionet, detyrimet dhe aktet e kushtëzuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 28-41 të Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa të përlllogarisë dhe regjistrojë provigjionet për humbjet e mundshme nga çështjet gjyqësore, për të siguruar që pasqyrat financiare të pasqyrojnë saktë detyrimet e mundshme.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua se në vitin 2023 janë paguar gjoba për pagesë me vonesë dhe kamatëvonesa për pagesat e tatimit fitimit të vitit 2019 dhe vitit 2020 në vlerën 570,569 lekë. Kjo shumë përbën një efekt financiar negativ, pasi ka gjeneruar kosto shtesë për buxhetin e shoqërisë dhe përfaqëson një shpenzim të kryer në pa ekonomikitetit. Mos analizimi i arsyeve të pagesave me vonese të tatimit mbi fitimin dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave me vonesë dhe në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative për shoqërinë.

Veprimet janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-28 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive administrative për personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të shoqërisë në vlerën 570,569 lekë, për gjoba dhe kamatëvonesa, të paguara për vonesat në likuidimin e tatimit mbi fitimin për vitet 2019 dhe 2020.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës u konstatua se në muajin shtator 2025 janë paguar gjoba për pagese të vonuar për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë në vlerën 142,681 lekë. Kjo shumë përbën një efekt financiar negativ, pasi ka gjeneruar kosto shtesë për buxhetin e shoqërisë dhe përfaqëson një shpenzim të kryer në pa ekonomikitetit. Mos analizimi i arsyeve të pagesave për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave me vonese e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative për shoqërinë.

Veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-28 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive administrative për personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të shoqërisë në vlerën 142,681 lekë, gjoba dhe kamatëvonesa, për pagesat me vonesë të taksavet dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera në R. Bank u konstatua se në muajin shkurt 2025 janë paguar 2,274,257 lekë për vendime gjyqësore për largimet nga puna nga të cilat 2,073,135 lekë shpenzime gjyqësore, 99,975 lekë tarifa gjyqësore dhe tarifa përbarimore 100,397 lekë.

Kjo shumë e paguar konsiderohet efekt negativ financiar, duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shoqërisë dhe janë shpenzime pa ekonomikitet. Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia në proceset e pagesave të vendimeve gjyqësore në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhetin e shoqërisë.

Veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2, neni 4 pika 22/1 dhe pika 24, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 21-28 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albafilm sh.a të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të shoqërisë në vlerën 2,274,257 lekë, shpenzime gjyqësore dhe përbarimore mbi pagesën e kryer për vendimet gjyqësore për gjyqe fituesin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

